

MENDIM PARALEL

Une gjyqtare Blerona Hasa, parashtror mendimin tim në çështjen administrative Nr.1 Akti Dt.17.02.2022, me:

PADITËSE: Lëvizja e Re.

IPADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

KUNDER: Vendimit nr.08, datë 15.02.2022 “Për Shqyrtimin e Kërkesës Ankimore Nr.03, të paraqitur në KQZ në datë 12.02.2022” të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me anë të së cilës është vendosur:

- Pranimin pjesshëm të kërkesës ankimore nr.03, datë 12.02.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 72, datë 12.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim.
- Brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, subjekti “Lëvizja e Re” të bëjë plotësimin e vërtetimit për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor, ose depozitimin e listës me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve, sipas pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.

OBJEKTI: Shqyrtimin e çështjes në themel dhe ndryshimin e vendimit nr.72 datë 12.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve duke vendosur: Regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

Kolegji Zgjedhor, në trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Gentian Medja kryesues, me anëtarë Alma Kolgjoka, Blerona Hasa, Esmeralda Çeka (Xhili) dhe Sokol Ibi, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendosi rrëzimin e kërkespadiës.

Unë gjyqtare Blerona Hasa, duke vlerësuar sikurse shumica, se kërkespadija duhej të ishte rrëzuar plotësisht, bëj me dije se një qëndrim i tillë diktohet jo nga argumentat e parashtruara nga shumica në vendimin e saj, por nganjëjtjetër shkak, analizuar prej meje në vijim.

Nga faktet e pasqyruara në aktet provuese të administruara në gjykim, ka rezultuar se:

- Më datë 08.02.2022, subjekti zgjedhor Lëvizja e Re (LRE) ka dorëzuar dokumentacionin për Z. Jonid Robert Nano, kandidat i saj për kryetar bashkie në qytetin e Durrësit, për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, duke bashkengjitur edhe vetëdeklarimin e Znj. Alneida Nexhmi Rroshi e cila, në cilësinë e anëtares së Këshillit të Bashkisë Durrës, konfirmonte mbështetjen e saj për kandidatin e subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”;

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vlerësuar, dokumentacioni përmbante pasaktësi që konsistonin në faktin se, subjekti zgjedhor nuk dispononte mandat në Këshillin e Bashkisë Durrës, duke arsyetuar në këtë kontekst se, vetëdeklarimi i Znj.AlneidaNexhmi Rroshi, nuk përmbushte kushtin ligjor sipas përcaktimeve të Pikës 3, të Nenit 68, të Kodit Zgjedhor, që parashikon se:“3. Për qëllim të këtij neni, *partia politike* ose koalicioni *paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësisë e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike, në institucionin përkatës*”.
- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet Shkresës Nr.788 Prot.Dt.11.02.2022, rezulton t’i ketëkërkuarKëshillit të Bashkisë Durrës, konfirmim mbi përkatësinë e subjektit politik qëpërfaqësonZnj.AlneidaRoshinë këtë institucion;
- Këshilli i Bashkisë Durrës, nëpërmjet Shkresës Nr.1372/1 Prot. Dt.11.2.2022, rezulton të ketë konfirmuar faktin e tëqenuritëZnj.AlneidaNexhmi Rroshi, anëtare e KëshillitBashkiak Durrës, përfaqësuese e subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbi bazën e këtyre fakteve rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.72 Dt.12.02.2022, që konsiston në: “Mosregjistrimin e kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, z.Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022...”,me arsyetimin se:“Subjekti zgjedhor nuk disponon mandat në këshillin bashkiak, Durrës. Vetëdeklarimi i zj. AlneidaNexhmi Rroshi, anëtare e këshillit bashkiak Durrës, se mbështet kandidatin e subjektit “Lëvizja e Re”, nuk përmbush kushtin ligjor të përcaktuar në pikën 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor”.
- Subjekti zgjedhor Lëvizja e Re rezulton të ketë investuar Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet Kërkesës Ankimore Nr.03 Prot. Dt.12.02.2022, me objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr.72 datë 12.02.2022 dhe pranimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin si kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Durrës të z.Jonid Robert Nano, për shkak të moszbatimit të afateve procedurale të përcaktuara nga Vendimi nr.02 prot, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”.
- Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve rezulton të ketë disponuar Vendimin Nr.08 Dt.15.02.2022, që konsiston në: “1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr.03, datë 12.02.2022, të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”. 2. Shfuqizimin e vendimit nr.72, datë 12.02.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për shqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, z.Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim. 3. Brenda 24 orëve nga shpallja e këtij vendimi, subjekti “Lëvizja e Re” të bëjë plotësimin e vërtetimit për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas kërkesave të pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor, ose depozitimin e listës me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhëve, sipas

pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor. 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij”.

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërfundim të afatit prej 24 orësh caktuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, rezultoi të ketë rishqyrtuar mëdatë 16.02.2022 (ditë e mërkurë) ora 16.00, kërkesën ankimore të subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”, me objekt: *“Për rishqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*
- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezultoi të ketë disponuar **në prani të subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”**, Vendimin Nr.79 Dt.16.02.2022, që konsiston në: *“Mosregjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 3. **Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve”.***
- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve rezultoi ta ketë bazuar vendimin në argumentin se:

“...në respektim të vendimit nr.8, datë 15.2.2022, të KAS, ditën e mërkurë, më datë 17.09.2021, ora 16:00, në përputhje me përcaktimet e nenit 47 dhe 87 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rishqyrtoi çështjen, duke zhvilluar një seancë publike, në të cilën u thirr për të qënë prezent në mbledhje përfaqësuesi i subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”.

- Në seancën e rishqyrtimit të çështjes i pranishëm ishte kryetari i subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re” z.ArianGaldini.

- Kryetari i subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”, kërkoi regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, në bashkinë Durrës, z. Jonid Robert Nano.

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se:

- Në përfundim të afatit për depozitimin e dokumentacionit të kërkuar, konstaton se subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, nuk depozitoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vërtetimin për zotërimin e mandatit përfaqësues sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 68, të Kodit Zgjedhor ose listën me nënshkrimet mbështetëse të zgjedhësve, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor.

- Bazuar në nenin 68, pika 3, të Kodit Zgjedhor, vërtetimi për zotërimin e mandatit përfaqësues bën pjesë në listën e dokumentave të kandidimit për t’u depozituar nga kandidati për kryetar bashkie. Mungesa e vërtetimit mund të zëvendësohet me listën mbështetëse prej jo më pak se 1 përqind e numrit të zgjedhësve, në zonën zgjedhore ku kandidon kandidati për kryetar bashkie.

- Sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 68, të Kodit Zgjedhor, vërtetimi për zotërimin e mandatit duhet të lëshohet nga Kuvendi i Republikës ose nga organi i vetëqeverisjes vendore, dhe duhet të konfirmojë faktin se mbështetur në vetëdeklarimin pranë institucionit nga ana e mbajtësit të mandatit, subjekti zgjedhor kërkues zotëron një mandat përfaqësues me vlefshmëri jo më pak se 6 (gjashtë) muaj deri në përfundim të mandatit të organit përkatës.

Për sa më sipër konstatohet se, mungesa e depozitimit të dokumentacionit të kërkuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie, në bashkisë Durrës, z.Jonid Rober Nano, nuk është në përputhje me përcaktimet e nenit 68, pika 3, të Kodit Zgjedhor”.

- Më datë 17.02.2022, subjekti zgjedhor Lëvizja e Re ka investuar me padi Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, duke bërë pjesë të kerkimevetë saj:

1. Vendimin Nr.72 Dt.12.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
2. Vendimin Nr.08 Dt.15.02.2022 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve.

Mbi bazën e këtyre fakteve, vlerësoj se:

Subjekti zgjedhor Lëvizja e Re ka investuar me padi Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, një ditë pasi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kishte disponuar, në prani të subjektit, Vendimin Nr.79 Dt.16.02.2022, që konsistonte në: *“Mosregjistrimin e kandidat për kryetar në bashkinë Durrës, z.Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Lëvizja e Re”, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*

Pavarësisht këtij fakti, subjekti zgjedhor Lëvizja e Re rezulton të ketë bërë pjesë të objektit të padisë, dy kerkimeqë lidhen me një procedurë shqyrtimi ankese **të rishqyrtuar** nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Subjekti zgjedhor Lëvizja e Re rezultoi të mos e kishte ankimuar në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, Vendimin Nr.79 Dt.16.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në këtë kontekst, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor rezulton të jetë investuar me padi për:

- shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit Nr.72 Dt.12.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
- shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit Nr.08 Dt.15.02.2022 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, në një kohëkur:
 1. Vendimi Nr.72 Dt.12.02.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ishte shfuqizuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me Vendimin Nr.08 Dt.15.02.2022;
 2. Vendimi Nr.08 Dt.15.02.2022 i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve rezultonte i ekzekutuar, nëpërmjet rishqyrtimit, me Vendimin Nr.79 Dt.16.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
 3. Vendimi Nr.79 Dt.16.02.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve rezultonte i formës së prerë, për shkak mosushtrimikundër tij, të të drejtës së ankimit në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve;
 4. Vendimi Nr.79 Dt.16.02.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk rezultonte pjesë e objektit të padisë së dorëzuar më datë 17.02.2022.

Rrjedhimisht, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor rezulton të jetë investuar me padi nga një subjekt të cilit, në kohën e ngritjes së padisë dhe disponimit të vendimit të Kolegjit, i është refuzuar regjistrimi, me një tjetër vendim të formës së prerë.

Në këtë kontekst, vënia në diskutim gjyqësisht e dy vendimeve që lidheshin me një kërkesë ankimore të rishqyrtuar nga Komisioneri me vendim të formës së prerë, nuk mund të realizojë asnjë interes për paditesin/ subjektin zgjedhor Lëvizja e Re. Ky i fundit rezultoi që, më datë 17.02.2022 (data e ngritjes së padisë), të ketë qenë afat për të kundërshtuar, sipas procedurës së parashikuar në Kodin Zgjedhor, Vendimin Nr.79 Dt.16.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, por pavarësisht këtij fakti rezultoi të ketë zgjedhur të bëjë objekt shqyrtimi në Kolegj, vendimmarrje që nuk sjellin më asnjë pasojë për të.

Në funksion të argumentimit të qëndrimit tim, i referohem Rregullores “Përmënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, miratuar me Vendimin Nr.03 Dt.06.11.2020 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në Nenin 9/8 të të cilit parashikohet se:

“Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankimi në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstron një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit”.

Referuar këtij standardi vlerësoj se, duke konfirmuar ekzistencën e një interesi të ligjshëm, me të drejtë Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve ka marrë në shqyrtim kërkesën ankimore të subjektit zgjedhor Lëvizja e Re, kundër Vendimit Nr.72 Dt.12.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ashtu sikurse do të vlerësoj aplikimin e këtij kushti, në rast se, në momentin e ngritjes së padisë, nuk do të kishte një tjetër vendim të Komisionerit lidhur me të njëjtin subjekt zgjedhor dhe të njëjtën kërkesë ankimore të tij.

Për sa më sipër vlerësoj se, nëpërmjet padisë me të cilën ka investuar Kolegjin, subjekti zgjedhor Lëvizja e Re nuk mund të realizojë interesin e tij të ligjshëm për regjistrimin e kandidatit të përzgjedhur prej saj, për sa kohë nëpërmjet kësaj padie, edhe në rast pranimi, ky subjekt politik do të vijonte të mbetej një subjekt zgjedhor të cilit i refuzohej regjistrimi i kandidatit, sipas një vendimi të formës së prerë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

GJYQTARE

Blerona HASA